



SHENIME DHE SPECIFIKIME TEKNIKE

PER OBJEKTET :

MBROJTJE NGA LUMENJETE

Dhjetor 2016

SHENIME E SPECIFIKIME TEKNIKE

TE PERGJITHSHME

- Keto shenime teknike jane pjese perberese e projektit dhe do te lexohen se bashku me fletet e tjera te projektit

Specifikimet teknike te meposhtme jane specifikime te pergjithshme.

N.q.se në projektet e zbatimit hasen shenime te ndryshme te vendosura nga projektusit lidhur me kushtet teknike apo teknologjine qe duhet zbatuar per ndertimin e vepres,ato shenime teknike, marrin perparesi ndaj specifikimeve te pergjithshme te meposhtme dhe duhen zbatuar me rigorozitet nga Kontraktori.

Specifikimet teknike te meposhtme plotesojne shenimet teknike qe shoqerojne projektin se bashku me fletet e vizatimeve dhe ne preventivat apo analizat e tyre.

Njohja me objektin dhe masat e nevojshme per realizimin e ndertimit

Para fillimit te punimeve kontraktori duhet të programoje inspektime per vleresime te objektit ,te sqaroje dhe /ose te kerkoje sqarime te nevojshme per probleme qe lidhen me objektin, nder te cilat mund te permenden , por nuk kufizohen si:

- Te njihet me vepren dhe shtrirjen e saj (perfshi edhe nen objektet) dhe te studjoje menyren se si pjese te veçanta apo nenobjekte te saj lidhen midis tyre , se pari ne viztimet e vepres dhe me tej si lidhen ato ne terren .
- Duhet bere studime ne terren per kushtet e ndertimit, por pa u kufizuar, në rrugët për shërbimet/telekomunikimet dhe zonat e banuara që ndikohen nga punimet.
- Kontraktuesi është përgjegjës i vetëm për të gjitha transportet e tij dhe nevojat e transportit në terren. Kontraktuesi duhet të ketë mbledhur të gjitha informacionet



e nevojshme për të bërë vlerësimin e tij të kushteve dhe kapaciteteve të rrugëve dhe urave, si dhe është përgjegjës për çdo rehabilitim ose përforsim të nevojshëm për kërkesat e tij.

- Kontraktuesi do të jetë gjithashtu përgjegjës për të gjitha shërbimet shtesë që mendohen të nevojshme për plotësimin e punimeve të cilat përfshijnë por pa u kufizuar: furnizimin me energji, telekomunikimin, furnizimin me ujë dhe menaxhimin apo largimin e mbetjeve të ngurta etj.
- Kontraktuesi duhet t'i lejojë punëdhënësit dhe Supervizorit përdorimin e arsyeshëm të shërbimeve në lidhje me Punimet gjatë progresit të tyre.
- Kontraktuesi duhet të përcaktojë kërkesat e përgjithshme të sigurisë për Punimet për miratim nga Punëdhënësi dhe Supervizori dhe të veprojë në përputhje me këto kërkesa si dhe është përgjegjës për këto veprime të personelit të tij në lidhje me kërkesa të tilla.
- Kontraktuesi është përgjegjës për sigurinë e Punimeve, të cilat përfshijnë digat dhe objektet përkatëse si dhe siguron dhe ruan vazhdimisht forcën e duhur të sigurisë për të përmbushur këto detyrime.
- Kontraktuesi duhet të sigurojë punëtore me qëllim që të ndihmojë Supervizorin dhe Punëdhënësin në operimet e tyre lidhur me mbikëqyrjen e Punimeve.

Azhornimet Topografike dhe kontrolli i punimeve te planifikuara

Në terren janë bërë matjet topografike dhe projekti ka përcaktuar nepermjet vizatimeve apo shenimeve te veçanta ne keto vizatime se cilat jane pikat fikse dhe orientuese per te ripiketuar ose azhornuar pjese apo segmente te veçanta te vepres , mbi bazen e te cilave janë përcaktuar volumet e punimeve, pikat e përkohshme të referimit mbi bazen e te cilave jane hartuar vizatimet dhe projekti punimeve.



Kontraktuesi është përgjegjës që me shpenzimet e tij të verifikojë, konfirmojë ose në të kundërt të kerokje sqarime apo te propozoje te ndryshojë të dhënat që jepen në projekte apo dokumentet teknike qe ai ka në dispozicion.

Ne çdo rast eshte pergjegjesi e kontraktuesit per kontrollin dhe për zbatimin e te gjitha këtyre të dhënave qe shprehen ne projekte apo preventiva.

Të gjitha pikat e pandryshueshme, pikat e referimit shtese si dhe pikat te tjera ndihmese qe jane vendosur nga projektuesi apo të vendosura nga Kontraktuesi, duhet të sigurohen (te mbrohen) në mënyrë të qëndrueshme e në pozicionet të pandryshueshme, të mbrojtura mirë dhe të shënuara qartë.

Kontraktuesi duhet të ruajë të gjitha këto pika dhe shenja për matjet e nevojshme dhe do t'ja dorezoje ato bashke me objektin Punëdhënësit apo Perfituesit.

Per realizimin e punimeve ne veprat e mbrojtjes nga lumenjte , pervecse sa me siper duhet te mbahen parasysht edhe :

NE REALIZIMIN E PENELAVE :

-Per realizimin e punimeve te dherave ,

- Ne germim apo mbushje, ne te gjitha rastet , me pare eshte e detyrueshme te behet perpunimi i bazamenteve duke realizuar se pari, skarifikimet , dhe largimet e materialeve te papershtatshem.
- -Te gjitha punimet per germime apo mbushje per formimin e seksionit terthor ku do te mbeshtetet peneli, do te behen ne perputhje me seksionin tip dhe specifikimet teknike qe shoqerojne kete projekt.

- Per orientimin dhe zgjedhjen e pozicionit te vendosjejs se penelave te shfrytezohet planimetria me Shkallen e caktuar qe jepet ne projekt duke u orientuar nga pikat fikse , qe pergjithesisht percaktohen ne relievet e hartuara ne Shk. 1 : 1000 ; 1: 2000 etj.



- Para se te fillohet nga puna , nga ana e zabtuesit do te behet piketimi dhe azhornimi i profilit gjatesor te penelit dhe ne asnje rast nuk do te fillohet nga puna pa u bere me pare konfirmimi nga supervizori dhe punedhenesi.

- Ne zerin " *germim dheu per vepren* " perfshihen te gjitha punimet e nevojshme qe duhet te kryhen ne çdo penel per realizimin profilit gjatesor te tij ne perputhje me projektin e dhene.

Eshte e domosdoshme te theksohet se duhet kontrolluar profili gjatesor i penelit ne menyre qe shtresa e pare (e poshteme) e penelit te qendoje ne bazament relativisht te qendrueshem (zhavore) ose ne rastet kur gjate trasimit te profilit gjatesor te penelit hasen zona me depresion (te ulura , gropa uji etj) atehre ne çdo rast nivelimi i bazamentit te penelit (nivelacioni i shtreses se pare) duhet te realizohet me mbushje me gure relativisht te medhenj me $d > 30$ cm e deri ne 100 cm

PUNIMET E BETONIT MONOLIT OSE PER BLOQE

Lloji I betonit qe do te perdoret do te jete sic specifikohet ne vizatime,ne preventive ose siç urdherohet nga Supervizori.

Karakteristikat e llojeve te ndryshme te betoneve jepen ne standartet Shteterore te Kushteve Teknike te Zbatimit (KTZ).

Pervec kur specifikohet ndryshe ,betonet do te prodhohen dhe trajtohen ne perputhje me keto standarte.

Para se te fillohet pergatitja e betoneve duhet te ***Percaktohet receta e pergatitjes se betonit***

Menyra e percaktimit te recetes se betonit jepet ne Standartet Teknike.

Kontraktori nuk duhet te filloje pergatitjen e betoneve pa provuar fillimisht nje kampion te betonit sipas recetes se projektuar per llojin perkates se betonit dhe me miratim te Supervizorit.



Ndryshimet ne receten e betonit mund te behen vetem me pelqimin e Supervizorit.

Kontraktori duhet te pergatis kampione per cdo lloj betoni me te njetat pajisje material me te cilat ai do pergatis betonin ne veper.

Ai duhet te njoftoje Supervizorin 24 ore para per keto prova ne menyre qe te marre pjese gjate marrjes se kampionev, te cilet do te provohen ne prani te Supervizorit , 3 pas 7 diteve dhe 3 te tjerat pas 28 diteve.

Receta aprovohet nga Supervizori n.q.s provat me kampionet e marra rezultojne me marke betoni me te madhe ose te barabarte me ate te parashikuar nga projekti.

Mostrat dhe provat e betonit gjate zbatimit te punimeve

Kontraktori eshte pergjegjes per ti siguruar Supervizorit kampionet e betonit dhe te perberesve te tij per tu provuar ne labororet e paracaktuar nga Supervizori.

Per kete qellim pergatiten kube betoni ne perputhje me standartin STASH 566.Keto kube do te merren nga perzierjet e betonit me frekuence sipas porosise se Supervizorit.

Kubet e betonit cohen nga Kontraktori ne vendin e percaktuar nga Supervizori.Prova te tjera mund te behen nga Supervizori edhe ne terren si p.sh ulja e konusit, per percaktimin e plasticitetit, lageshtise etj.

Kontraktori duhet ti siguroje Supervizorit kushtet e nevojshme per kete qellim.

Gjithe paisjet e nevojshme per marrjen e kampioneve, i sigurohen Supervizorit nga kontraktori.

Per cdo perzierje prove betoni merren 6 kube,3 nga te cilet provohen pas 7 ditesh dhe 3 mbas 28 ditesh.prova 28 ditore do te jete ajo e cila do krahasohet me standartin e percaktuar ne projekt.



- Pergatitja e blloqeve do te behet ne fushen e prodhimit dhe atje do te behet edhe kontrolli dhe pranimi i tyre nga supervizioni para se ato te transportohen per ne veper.

- Blloqet e betonit do te vendosen ne veper pasi te jene stazhionuar ne fushe jo me pak se 21 dite.

Vendosja e tyre do te behet gjithnje ne perputhje me seksionin terthor tip qe jepet ne projekt duke respektuar nivelet dhe distancat qe ata shkelin mbi njeri tjetrin apo qe duhet te jene larg njeri tjetrit.

- Nuk do te filloje vendosja blloqeve ne nivelin e mesiperme pa u realizuar me pare e pa u konfirmuar nga supervizioni lidhja me unazat metalike e blloqeve te nivelit te meposhtem gjithnje komform modelit te dhene ne projekt.


SKOLIERA-at ME GURE

-Skoliera me gure parashikohet ne projekt dhe pergjithesisht perdoret kur eshte e domosdoshme zvogelimi me skolere (me mbushje me gure te hedhur) thellesia e shtratit te lumit ne aksin e penelit.

Ne keto raste para fillimit te vendosjes se koshave te gabionave te mbushur me gure (qe pergjithesisht perfaqesojne shtresen e pare te penelave) dhe me tej te rreshtave me blloqe te penelit behet, nje mbushje me gure (shkembinj) relativisht te medhenj me D 0,5- 1, m, ne forme te nje skoliere , e cila do te mund te krijoje kushte per vendosjen e shtreses se pare te penelit ,shtresa me gabiona .

Gjithashtu me gure te tillë(me shkembinj) do te mbushen edhe zona te vecanta ne forme depresioni (ulje apo gropa te ndryshme ne shtratin ku vendoset peneli) qe mund te jene krijuar nga gerryerje te mundeshme ne shtratin e lumit ose taraces ku mbeshtetet peneli.

Pergjithesisht , sugjerohet qe keto punime, skoliera me gure dhe rreshti pare i penelit, te kryhen ne nje periudhe relativisht ujepaket , duke presupozuar qe shtresa me gabiona te mos jete e zhytur ne uje (ne periudhen e ndertimit) me shume se 1 m



Shenime dhe specifikime teknike per objekte te mbrojtjeve nga lumenjte.

Eshte provuar se ne kete thellesi, me mjete te posaçme e paisje te gomuara , mund te behet montimi, perforcimi dhe mbushja me gure e gabionave ne rreshtin e pare.

- Per nivelimin e bazes se kokes penelit,dhe te bazes se inkastrimit me bregun ,ne asnje rast nuk do te aplikohet mbushje me dhe' por vetem mbushja qe rekomandohet si me siper ose specifikohet ne fletet e vizatimit.

- Rrjeta e gabionit qe do te sherbeje per realizimin e shtresave (rreshtave te penelit) eshte parashikuar te jete nje **rrjete hekuri speciale , pergjithesisht me saldim me kontakt**, e cila duhet te plotesoje te gjithe parametrat dhe specifikimet teknike qe jepen ne fleten e veçante te vizatimit per kete detaj gabioni(Shih).

Hekuri

Hekuri qe do te perdoret ne kantjer duhet te permbush kerkesat dhe specifikimet teknike sipas kushteve teknike te zbatimit (KTZ) te miratura nga Standartet Shteterore si dhe ato qe specifikohen ne shenimet teknike te projektit.

Kontraktori duhet ti japi Supervizorit certifikaten e fabrikes nga ku eshte marre hekuri per te pare perputhjen me standartin.Hekuri duhet te ruhet duke mos patur kontakt direkt me token dhe te evitohen deformimet.

Supervizori ka te drejte te kontrolloje menyren e depozitimit te hekurit.

Hekuri duhet te pritset dhe te kthehet ne perputhje me vizatimet dhe tabelat.

Ne rastet kur nevojitet (rasti i gabionave) ai duhet te pritset dhe te kthehet ne te ftohte me paisjet e pershtatshme te aprovuara nga Supervizori.

Kthimet me reze shume te vogel nuk duhet te lejohen.

Para betonimit ,vendosja e hekurit duhet te kontrollohet dhe miratohet nga Supervizori.

Pervecese kur eshte kerkuar ndryshe,shtresa mbrojtese e betonit per hekurin duhet te jete jo me pak se 25-30mm.



Shenime dhe specifikime teknike per objekte te mbrojtjeve nga lumenjte.

- Ne çdo rast , me perjashtim te unazes lidhese te blloqeve, te gjitha ganxhat apo detajet e tjera metalike do te vendosen gjate betonimit te blloqeve ne fushen e prodhimit te tyre (perjashtim bejne ketu ganxhat qe vendosen ne betonin monolit te cilat vendosen gjate betonimit te ketyre segmenteve te peneleve).

- Gjate prezantimit te nje partie (pakete) me nje numur te caktuar prej blloqeve qe kontraktori mendon per ti transportuar ne objekt , duhet ti parqes supervizorit edhe analizen e markes se betonit dhe çertifikaten e garancise se hekurit qe eshte perdorur per ganxhat.

- Kushtet teknike te mesiperme do te respektohen edhe per zonat e inkastrimit te mbrojtjes duke patur parasysh realizimin dhe lidhjen natyrale te penelit me bregun ne perputhje me dimensionet e projektit. etj.

- Keto shenime do te lexohen se bashku me shenimet e tjera teknike qe jepen ne fletet e vizatimit te projektit si dhe shenimet qe jepen ne preventivat dhe analizat e çmimeve (te cilat kane perparesi ndaj shenimeve te mesiperme).

